

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSIONI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT PËR LAGJET GËRHOT DHE VIRUA”, BASHKIA GJIROKASTËR.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për ujësjellës 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 53,868,015 (pesëdhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me ligjin nr. 16/2024, si dhe neneve 2, pika 2/c, 7, pika 3, 26, 39, 43, 44 dhe 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Njësia e Prokurimit harton këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Argumentimi është kryer duke iu referuar projekt-preventivit, analizave teknike të çmimeve dhe grafikut të punimeve. Preventivi përfshin: pikën e lidhjes në rezervuarin e Granicës; linjat e dërgimit; pusetat e ajrimit dhe shkarkimit; rezervuarin dhe rrjetin shpërndarës të lagjes Gërhót; rezervuarin dhe rrjetin shpërndarës të lagjes Virua; pusetat e komandimit, reduktimit të presionit dhe hidranteve; lidhjet me objektet dhe muret për instalimin e matësve. Vlera e fondi limit **53,868,015 (pesëdhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë, pa TVSH.**

Grafiku parashikon realizimin brenda 6 muajve, me fronte pune që mbivendosen: linjat e dërgimit, rezervuarët dhe rrjetet shpërndarëse, lidhjet me objektet, muret e matësve dhe testimet. Ky organizim kërkon kapacitete të mjaftueshme financiare, personel të specializuar, makineri dhe kontroll cilësie, por kriteret duhet të kufizohen vetëm në atë masë që lidhet drejtpërdrejt dhe në mënyrë proporcionale me objektin.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social	pikët 10

Kjo kërkesë është bërë në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” ku përcaktohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose
b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Njësia e Prokurimit shpalli kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar për këtë kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin me sukses të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve, por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë, ndihmës etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor por dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të plotë të operatorit ekonomik pjesëmarrës i cili në përfundim do të sjellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga ky autoritet. Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi / Organizimi i Kompanisë, i cili vlerësohet deri në 15 pikë, duke ditur që vetëm një staf i kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me përvojën e duhur mund të sjellë rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik i cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë / eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe

eksperienca në fushën specifike i cili provohet me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që me veprimet apo mosveprimet tona ndikojmë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht / negativisht. Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, florë dhe faunë, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj.

Në veçanti duhet t'i kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paraqitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Për të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të çdo operatori ekonomik ofertues. Nënkriteret për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave i Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

1. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efëcente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.
2. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.

Një rëndësi e vecantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetëgjatësinë e objektit, faktin se sa më maksimale të jetë periudha që përfshin garancinë e veprës, e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.

Një rëndësi të vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet dhe punësimin të punëkerkuesve ku Operatori Ekonomik fitues garanton se do të punësojë një numër personash, të cilët klasifikohen si “punëkerkues pa punë” duke i kushtuar një vëmendje të vecantë punësimit të personave të papunë, kryesisht në zonën ku do të zhvillohet procedura e prokurimit.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 16 datë 08.02.2024 Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor SHRUKGJ, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, apo personit me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese, persona të cilët janë ose kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, gjatë kohës që vendimi i përjashtimit është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet për pagat bazë referuese sipas kategorive të profesioneve për punonjësit e punësuar, kur kjo kërkesë zbatohet.

Dokumentet në gjuhë të huaj paraqiten të shoqëruara me përkthim në gjuhën shqipe sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Këto kritere përmbushen paraprakisht me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik në ditën e hapjes së ofertave, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në rast se operatori ekonomik ofertues mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 8**;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

Argumentimi: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit kërkohet si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve, në zbatim të nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar. Sigurimi i ofertës kërkohet në zbatim të nenit 83 të LPP-së, për të garantuar seriozitetin e ofertës dhe mbrojtjen e autoritetit kontraktor nga tërheqja ose mosrespektimi i detyrimeve të ofertuesit gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes / Kualifikimit **pika 1 e Shtojcës 7**

Argumentimi: Kërkesa lidhet me zotësinë juridike dhe profesionale të operatorit për të lidhur dhe zbatuar kontratën, sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe objektit të veprimtarisë së regjistruar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomik duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, ky kriter plotësohet nga bashkimi në tërësi, sipas përqindjes së pjesëmarrjes dhe pjesës së kontratës që merr përsipër secili anëtar, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e

profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka shlyer detyrimet e maturuara të taksave dhe tarifave vendore në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të deklaruar në QKB, deri në datën e zhvillimit të procedurës, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, dhe afateve të miratuara nga njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet paraprakisht me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të dokumenteve standarde të tenderit. Dokumentacioni provues paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kriteret ekonomike dhe financiare mbështeten në nenin 77 të LPP-së dhe nenin 43 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar. Xhiroja minimale është caktuar në 50% të fondit limit, pra 26,934,007.35 lekë, dhe duhet të rezultojë në të paktën një nga vitet 2023, 2024 ose 2025. Ky nivel është i moderuar dhe i nevojshëm për të verifikuar aftësinë e operatorit për të financuar mobilizimin, furnizimin me tuba e rakorderi, transportin, punimet e betonit dhe zhvillimin paralel të fronteve të punës brenda afatit 6-mujor.

Kërkesa për bilanci e tre viteve të fundit synon të kontrollojë stabilitetin financiar. Ajo konsiderohet e përmbushur kur në dy bilanci të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit; akt-ekspertiza kërkohet vetëm kur operatori ndodhet në kushtet ligjore të auditimit. Kërkesa për taksat dhe tarifat vendore provon përmbushjen e detyrimeve publike në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe verifikohet për detyrimet e maturuara deri në datën e procedurës.

Në rast bashkimi operatorësh, përmbushja e këtyre kapaciteteve vlerësohet sipas rregullave për bashkimet dhe pjesës së kontratës që merr përsipër secili anëtar; nuk kërkohet që çdo anëtar të plotësojë individualisht të gjithë vlerën e xhiros kur legjislacioni lejon përmbushjen e përbashkët.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Në rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formularin e vlerësimit të lëshuar nga investitori, sipas Shtojcës 9, dhe situacionin përfundimtar, për të provuar realizimin me sukses të punimeve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë qartë cilësinë e kryerjes së punimeve, realizimin me sukses të kontratës dhe përqindjen e punimeve të kryera nga ofertuesi në rast bashkimi operatorësh.

Në rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, ku të evidentohen datat, vlerat dhe natyra e punëve të kryera, si dhe situacionin përfundimtar, për të provuar realizimin me sukses të punimeve.

Pika 2.3.1, shkronja “a”, plotësohet nga anëtari që ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë paraqesin përvojën e ngjashme në raport me përqindjen dhe pjesën e punimeve që marrin përsipër. Kur anëtarët kanë përqindje të barabarta, përcaktojnë në marrëveshjen e bashkëpunimit se cili prej tyre plotëson këtë kusht.

Pika 2.3.1, shkronja “b”, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes dhe pjesën e punimeve që marrin përsipër, në përputhje me nenin 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kriteri për punë të ngjashme mbështetet në nenin 77 të LPP-së dhe nenin 39, pika 5, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar. Për këtë fond limit, alternativa “a” përkon me një kontratë të vetme me vlerë jo më të vogël se 26,934,007.35 lekë pa TVSH, ndërsa alternativa “b” me kontrata të realizuara së bashku me vlerë jo më të vogël se 107,736,029.40 lekë pa TVSH, gjatë pesë viteve të fundit. Kërkimi në kufirin e lejuar synon të provojë përvojë reale në punime ujësjellësi, linja dërgimi dhe shpërndarjeje, rezervuarë, puseta, punime betonarme, gërmime dhe rikthim të shtresave rrugore.

Formulari i vlerësimit, situacioni përfundimtar, faturat tatimore dhe dokumentet e bashkimit/nënkontraktimit kërkohen vetëm për të identifikuar natyrën, vlerën dhe pjesën e punimeve të kryera realisht nga ofertuesi. Për bashkimet e operatorëve zbatohen rregullat e nenit 88 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, në raport me përqindjen dhe punimet e marra përsipër.

2.3.2 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale për zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe kategoritë e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë qëllim duhet të paraqitet licenca e shoqërisë, sipas formatit të miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P-1	(Punime gërmimi në tokë)	Klasifikimi B
N.P-4	(Rrugë, autostrada, mbikalime)	Klasifikimi A
N.P-7	(Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)	Klasifikimi C
N.P-12	(Punime të inxhinierisë mjedisore)	Klasifikimi B

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S-9	(Punime strukturore speciale)	Klasifikimi A
N.S-14	(Impiante të brendshme elektrike)	Klasifikimi A
N.S-18	(Punime topogjeodezike)	Klasifikimi B

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16. 01. 2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Licencat profesionale kërkohen në zbatim të nenit 39, pika 6/a, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar. Kategoritë lidhen drejtpërdrejt me zërat e preventivit: NP-1 me gërmimet në tokë dhe shkëmb, mbushjet dhe sistemimet; NP-4 me prerjen e asfaltit dhe rikthimin e nënshtresave, binderit dhe asfaltobetonit; NP-7 me punimet kryesore të ujësjellësit, tubacionet PE100 RC, rakorderitë, saracineskat, matësit, rezervuarët dhe pusetat; NP-12 me administrimin dhe rehabilitimin mjedisor të zonave të prekura; NS-9 me rezervuarët, pusetat, gabionet dhe elementet betonarme; NS-14 me instalimet elektrike të parashikuara; NS-18 me piketimin dhe kontrollin topogjeodezik të gjurmëve dhe kuotave.

Klasifikimet janë përcaktuar sipas vlerës së punimeve të kategorisë përkatëse. NP-7 kërkohet në klasifikimin C, pasi objekti është një sistem ujësjellësi me fond limit 53,868,014.70 lekë pa TVSH. Kategoritë ndihmëse NP-1, NP-4, NP-12, NS-9, NS-14 dhe NS-18 kërkohen në klasifikimin A&B, sepse

vlera individuale e secilës kategori nuk kalon pragun 20 - 50 milionë lekë. Ky përcaktim shmang kërkesa më të larta se vlera reale e punimeve dhe ruan proporcionalitetin e konkurrencës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor dhe mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 81 (tetëdhjetë e një) punonjës gjatë tre muajve të fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave. Përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Dokumentet provuese për numrin e punonjësve dhe marrëdhëniet e punësimit paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj të periudhës së mësipërme.
- b) Listëpagesat e punonjësve, sipas formatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet sistemit elektronik të administratës tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë si drejtues teknikë në licencën e shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi - 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi - 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet - 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik - 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog - 1 (një)
- Inxhinier Elektrik - 1 (një)
- Arkitekt - 1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|---------|
| • Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| • Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeodet | 1 (një) |

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur paraprakisht me vetëdeklarimin në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Ofertuesi i kualifikuar i pari paraqet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, kontratën e punës të vlefshme për periudhën e zbatimit, diplomën, librezën e punës dhe CV-në e drejtuesit teknik të deklaruar.

2.3.5 Krahas stafit teknik, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin mbështetës të mëposhtëm:

- Teknik Ndërtimi - 2 (dy)
- Teknik Topograf - 1 (një)
- Karpentier - 3 (tre)
- Murator -2 (dy)
- Saldator - 2 (dy)
- Hekurkthyes - 2 (dy)
- Suvatues - 2 (dy)
- Hidraulikë - 4 (katër)
- Hidroizolues - 2 (dy)
- Elektricitist - 2 (dy)
- Punonjës të konstruksioneve metalike - 2 (dy)
- Shoferë - 6 (gjashtë)
- Punëtorë të thjeshtë - 20 (njëzet)
- Manovratorë - 5 (pesë)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr.Diplome /Nr.Amze
-----	---------------------------	------------	--	---	---------------------

1					
2					
Etj.					

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH.”, i ndryshuar.
- Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë, minimalisht për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Për Teknikun e Ndërtimit, Teknikun Topograf, duhet të paraqitet dëftesë e shkollës së mesme.

Shënim: Për shoferët manovratorët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqiten: kontratë pune ose shërbimi e vlefshme; dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, e lëshuar nga organi kompetent; si dhe kartelë personale e sigurimit teknik e vlefshme, e lëshuar nga institucione shtetërore ose subjekte juridike private të akredituara/licencuara për certifikimin e punonjësve, sipas funksionit përkatës.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Numri mesatar minimal prej 81 punonjësish është lidhur me afatin 6-mujor dhe mbivendosjen e fronteve në grafik. Në periudhën e ngarkesës maksimale parashikohen njëkohësisht: ekipi i linjave të dërgimit; ekipet e rrjeteve shpërndarëse Gërhut dhe Virua; ekipi i rezervuarëve dhe pushtave; ekipi i rikthimit të shtresave rrugore; si dhe ekipi i lidhjeve, matësve dhe testimeve. Përllogaritja organizative orientuese është: 18 punonjës për linjat e dërgimit, 15 për rrjetin Gërhut, 15 për rrjetin Virua, 12 për rezervuarët/pushtat, 10 për shtresat rrugore, 6 për lidhjet dhe testimet, si dhe 5 punonjës drejtimi e koordinimi, gjithsej 81.

Profesionet e kërkuara burojnë nga analizat teknike të çmimeve dhe zërat e preventivit: inxhinierët e ndërtimit dhe hidroteknikë për organizimin e rrjeteve, rezervuarëve dhe strukturave; gjeodeti/topografi për gjurmët e tubacioneve; gjeologu për terrenin dhe gërmimet në shkëmb; inxhinieri elektrik për instalimet; inxhinieri mekanik për valvulat, pajisjet dhe montimet; inxhinieri i mjedisit për masat

mjedisore; teknikët, hidraulikët, saldatorët, karpentierët, hekurkthyesit, muratorët, hidroizoluesit, elektrikistët, shoferët dhe manovratorët për proceset konkrete të zbatimit.

Argumentimi i përgjithshëm ligjor

Kërkesat për personelin teknik dhe profesional janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6, shkronjat “c” dhe “ç”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar. Këto dispozita i japin Autoritetit Kontraktor të drejtën të kërkojë personelin kryesor dhe fuqinë minimale punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës, me kusht që kërkesat të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me natyrën, vlerën dhe aftësinë zbatuese të operatorit ekonomik.

Kërkesa për personelin është hartuar duke marrë në konsideratë vlerën e objektit, afatin 6-mujor, shtrirjen e punimeve në disa zona dhe nënobjekte, karakterin hidroteknik të veprës, si dhe nevojën për realizimin paralel të punimeve të gërmimit, betonarmesë, montimit të tubacioneve, pusetave, rezervuarëve, lidhjeve hidraulike, punimeve metalike dhe rifiniturave.

1. Inxhinier Ndërtimi -1 person

Argumentimi:

Kërkesa për një inxhinier ndërtimi është e domosdoshme për drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve civile dhe strukturore të objektit. Preventivi përfshin punime gërmimi dhe mbushjeje, struktura monolite betoni, mure, kolona, soleta, arkitrarë, vendosje armature, ndërtim pusetash, rezervuarë betonarme, gabiona, rikthim të shtresave rrugore dhe punime rifiniture. Vetëm në një nga nënobjektet parashikohen soleta dhe arkitrarë betonarme, si dhe mbi 8 tonë armaturë çeliku.

Inxhinieri i ndërtimit do të jetë përgjegjës për organizimin teknik të kantierit, kontrollin e zbatimit të projektit, ndjekjen e proceseve të betonimit dhe armimit, kontrollin e cilësisë së materialeve, respektimin e rendit teknologjik të punimeve dhe koordinimin me mbikëqyrësin e Autoritetit Kontraktor.

Për shkak se vlera e plotë e preventivuar e veprës është mbi 30,000,000 lekë, rregullorja aktuale kërkon që përgjegjësi teknik i kantierit të jetë rezident me kohë të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

2. Inxhinier Mjedisi - 1 person

Argumentimi:

Kërkesa për një inxhinier mjedisi lidhet me natyrën lineare të objektit dhe me ndikimet e mundshme që krijohen gjatë hapjes së kanaleve, gërmimit të tokës dhe shkëmbit, transportit të materialeve, depozitimit të dherave, punimeve pranë zonave të banuara dhe ndërhyrjeve në rrjetin ekzistues të ujësjellësit.

Inxhinieri i mjedisit do të jetë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e masave për:

- administrimin e dherave dhe mbetjeve inerte;
- parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave;
- kufizimin e pluhurave, zhurmave dhe ndotjes nga mjetet;
- sistemin dhe rehabilitimin e sipërfaqeve pas përfundimit të punimeve;
- mbrojtjen e komunitetit dhe pronave përreth;

- respektimin e detyrimeve mjedisore gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Preventivi për linjat e dërgimit përfshin gjurmime në tokë të fortë, rreth 590 m³ gjurmime në shkëmb, mbi 2,000 m³ gjurmime me ekskavator, transport dherash, mbushje dhe ngjeshje, të cilat krijojnë nevojë për kontroll të vazhdueshëm të ndikimeve mjedisore.

3. Inxhinier Gjeodet -1 person

Argumentimi:

Kërkesa për një inxhinier gjeodet është e nevojshme për piketimin dhe kontrollin planimetrik e altimetrik të linjave të ujësjellësit, rezervuarëve, pusetave, pikave të lidhjes, reduktorëve të presionit, hidrantëve dhe lidhjeve me abonentët.

Inxhinieri gjeodet do të kryejë:

- marrjen në dorëzim dhe verifikimin e reperëve;
- piketimin e gjurmëve të tubacioneve;
- përcaktimin e kuotave të gjurmimit dhe vendosjes së tubave;
- kontrollin e pjerrësive dhe pozicionit të veprave;
- matjen e volumeve të realizuara;
- përgatitjen e rëlevimeve përfundimtare “as-built”.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me shtrirjen e linjave dhe me kategorinë NS-18 “Punime topogjeodezike”, të kërkuar në dokumentet e tenderit. Rregullorja e kantierit përcakton gjithashtu marrjen në dorëzim të hartave, relieveve topografike dhe reperëve, si dhe verifikimin e saktësisë së piketimit të objektit.

4. Inxhinier Hidroteknik- 1 person

Argumentimi:

Inxhinieri hidroteknik është një nga specialistët kryesorë të nevojshëm, pasi objekti ka si qëllim rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit dhe përfshin linja dërgimi, rrjete shpërndarëse, rezervuarë, puseta ajrimi dhe shkarkimi, reduktorë presioni, hidrantë dhe lidhje me abonentët.

Ai do të jetë përgjegjës për:

- kontrollin e zbatimit të skemës hidraulike;
- respektimin e diametrave, klasave të presionit dhe kuotave të tubacioneve;
- montimin e tubave PE100 RC, rakorderive, saracineskave dhe valvulave;
- kontrollin e pikave të lidhjes dhe nyjeve hidraulike;
- provat e presionit, shpëlarjen, dezinfektimin dhe vënien në funksionim;
- koordinimin e ndërhyrjeve me rrjetin ekzistues.

Preventivi përfshin sasi të konsiderueshme tubacionesh PE100 RC, përfshirë rreth 4,750 ml vetëm në linjat e dërgimit, si dhe tubacione me diametra dhe presione të ndryshme.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me kategorinë NP-7 dhe me objektin kryesor të kontratës.

5. Inxhinier Gjeolog - 1 person

Argumentimi:

Kërkesa për një inxhinier gjeolog argumentohet nga lloji i punimeve të gërmimit dhe kushtet e ndryshme gjeologjike që mund të hasen përgjatë gjurmëve të tubacioneve dhe në zonat e ndërtimit të rezervuarëve e pusetave.

Preventivi përfshin:

- gërmime në tokë të fortë;
- gërmime në tokë të kategorisë III;
- rreth 590 m³ gërmime në shkëmb mesatar;
- gërmime të thella për tubacionet dhe veprat hidraulike;
- mbushje dhe ngjeshje të kanaleve;
- punime për themelet e rezervuarëve dhe pusetave.

Inxhinieri gjeolog do të japë asistencë gjatë hapjes së kanaleve dhe themeleve, do të vlerësojë natyrën e formacioneve të hasura, stabilitetin e skarpave dhe nevojën për masa mbrojtëse, si dhe do të ndihmojë në shmangien e uljeve, shembjeve apo dëmtimeve të tubacionit.

6. Inxhinier Elektrik - 1 person

Inxhinieri elektrik kërkohet për ndjekjen dhe kontrollin e instalimeve elektrike, furnizimit me energji, paneleve elektrike, kabllave, tokëzimit, ndriçimit, mbrojtjes elektrike dhe pajisjeve elektromekanike që do të instalohen në rezervuarë ose në veprat e tjera të objektit. Ai do të kontrollojë përputhshmërinë e instalimeve me projektin, parametrat teknikë të pajisjeve, masat e mbrojtjes nga kontakti elektrik dhe provat përpara vënies në funksionim.

7. Arkitekt - 1 person

Argumentimi i mundshëm:

Arkitekti do të ndjekë punimet arkitektonike dhe të rifiniturës që lidhen me objektet mbi tokë të rezervuarëve, përfshirë muraturat, suvatimet e brendshme dhe të jashtme, bojatisjet, dyert, dritaret, portat metalike dhe sistemin përfundimtar të objekteve. Preventivi përfshin suvatime, bojatisje, muraturë tulle, dyer dhe dritare alumini dhe porta metalike dekorative.

Janë kërkuar staf mbështetës:

Inxhinier Ndërtimi - 1 person shtesë

Argumentimi:

Inxhinieri shtesë i ndërtimit kërkohet për ndjekjen e përditshme të punimeve civile në frontet e ndryshme, për kontrollin e volumeve, proceseve të betonarmesë, pusetave, rikthimit të shtresave rrugore dhe dokumentacionit teknik të kantierit.

Nevoja për një inxhinier shtesë lidhet me faktin se grafiku parashikon zhvillim të njëkohshëm të punimeve në linjat e dërgimit, rezervuarët, rrjetet shpërndarëse dhe pikat e lidhjes.

Drejtuesi teknik rezident do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme të kantierit, ndërsa inxhinieri shtesë do të ndjekë drejtpërdrejt frontet e punës, matjet, situacionet dhe kontrollin teknik të proceseve të veçanta.

Inxhinier Mekanik - 1 person

Argumentimi:

Kërkesa për inxhinier mekanik lidhet me montimin e pajisjeve dhe elementeve mekanike të rrjetit, si:

- saracineska dhe valvula;
- reduktorë presioni;
- hidrantë;
- matës uji;
- tuba dhe elemente çeliku;
- fllanxha, xhunto çmontimi dhe rakorderi;
- konstruksione dhe kapakë metalikë.

Preventivi përmban konstruksione metalike, tuba çeliku, valvula ajërnxjerrëse, saracineska dhe elemente mekanike me fllanxha.

Inxhinieri mekanik do të kontrollojë montimin, lidhjet me fllanxha, saldimet, ankorimet, parametrat e presionit, funksionimin e pajisjeve dhe provat mekanike përpara marrjes në dorëzim.

Inxhinier Hidroteknik - 1 person shtesë

Argumentimi:

Inxhinieri hidroteknik shtesë mund të argumentohet me nevojën për ndjekjen paralelisht të punimeve në linjat e dërgimit dhe në rrjetet shpërndarëse Gërhut–Virua, ndërkohë që inxhinieri hidroteknik kryesor koordinon rezervuarët, pusetat, reduktorët e presionit, hidrantët dhe testimet përfundimtare.

Inxhinier Gjeodet - 1 person shtesë

Argumentimi:

Nëse një inxhinier gjeodet është kërkuar tashmë si personel kryesor, kërkesa për një inxhinier tjetër gjeodet duhet të mbështetet në punime të njëkohshme në dy zona ose në nevojën për një ekip të dytë topografik.

Për objektin konkret, një inxhinier gjeodet, i mbështetur nga një teknik topograf, është përgjithësisht i mjaftueshëm për piktet, matjet, kontrollin e kuotave dhe rlevimet përfundimtare.

DREJTUESI TEKNIK I PUNIMEVE

Drejtuesi/përgjegjësi teknik i kantierit do të jetë përgjegjës për zbatimin e përpiktë të projektit, respektimin e specifikimeve teknike dhe të rendit teknologjik, organizimin dhe instruktimin e punonjësve, kontrollin e materialeve dhe proceseve të punës, zbatimin e masave të sigurimit teknik, koordinimin me mbikëqyrësin dhe administrimin e dokumentacionit teknik të kantierit.

ARGUMENTIMI I PIKËS 2.3.5

Stafi mbështetës

1. Teknik Ndërtimi - 2 persona

Dy teknikët e ndërtimit kërkohen për ndjekjen e përditshme të punimeve civile në frontet e ndryshme, kontrollin e zbatimit të detajeve, matjen e volumeve, mbajtjen e evidencave ditore dhe asistencën ndaj drejtuesit teknik.

2. Teknik Topograf - 1 person

Tekniku topograf do të asistojë inxhinierin gjeodet në piketimin e gjurmëve, vendosjen dhe kontrollin e reperëve, matjen e kuotave të kanaleve, kontrollin e tubacioneve dhe përgatitjen e rlevimeve përfundimtare.

3. Karpentier - 3 persona

Karpentierët janë të nevojshëm për përgatitjen, montimin dhe çmontimin e kallëpeve për:

- muret e rezervuarëve;
- themelet dhe soletat;
- kolonat dhe arkitrarët;
- pusetat dhe bazamentet;
- elementet e tjera betonarme.

Analizat teknike përfshijnë mure betonarme rezervuari, kallëpe rezervuari, kallëpe themeli dhe skela.

Numri tre është përcaktuar për krijimin e një skuadre minimale pune që mund të realizojë në mënyrë të sigurt montimin, përforcimin dhe çmontimin e kallëpeve.

4. Murator - 2 persona

Muratorët kërkohen për ndërtimin e muraturave me tulla, plotësimet e pusetave, rregullimet rreth dyerve dhe dritareve, riparimet lokale dhe rikthimin e elementeve ndërtimore të dëmtuara gjatë ndërhyrjeve.

Preventivi përmban muraturë me tulla të lehtësuara, punime suvatimi dhe rifinitura të objekteve të rezervuarëve.

5. Saldator - 2 persona

Saldatorët kërkohen për realizimin dhe montimin e elementeve metalike, tubave të çelikut, flanaxhave, mbajtëseve, portave, kapakëve dhe konstruksioneve të ndryshme metalike.

Analizat teknike parashikojnë përdorimin e elektrosaldatriçes, elektrodave, flanaxhave prej çeliku dhe elementeve të salduara në montimin e saracineskave dhe rakorderive.

Dy saldatorë formojnë një kapacitet minimal për kryerjen paralelisht të përgatitjes, saldimit dhe montimit të elementeve metalike.

6. Hekurkthyes - 2 persona

Hekurkthyesit janë të nevojshëm për prerjen, drejtimin, përkuljen, lidhjen dhe montimin e armaturës së elementeve betonarme.

Preventivi përmban armaturë periodike me diametra mbi 12 mm dhe 6–10 mm, në rezervuarë, puseta, themele, mure, soleta dhe arkitrarë. Vetëm në rezervuarin e Gërhotit parashikohet mbi 8 tonë armaturë.

Numri dy përbën një skuadër minimale për përgatitjen dhe montimin e sigurt të armaturës.

7. Suvatues - 2 persona

Suvatuesit do të realizojnë suvatimet e brendshme dhe të jashtme të ndërtesave të rezervuarëve, tavaneve, muraturave dhe sipërfaqeve të tjera të parashikuara në preventiv.

Preventivi përmban suva solete, suva të brendshme të muraturës dhe suva fasade.

Dy persona janë të nevojshëm për përgatitjen, aplikimin dhe përfundimin e shtresave në mënyrë të njëtrajtshme.

8. Hidraulikë - 4 persona

Hidraulikët janë personeli kryesor për montimin e rrjetit dhe kërkohen për:

- shtrimin dhe bashkimin e tubave PE;
- montimin e rakorderive elektrofuzive;
- montimin e saracineskave dhe valvulave;
- lidhjet me rezervuarët dhe abonentët;
- instalimin e hidrantëve dhe reduktorëve të presionit;
- provat e presionit, shpëlarjen dhe vënien në funksionim.

Për shkak të gjatësisë së rrjetit dhe zhvillimit të punimeve në disa fronte, kërkohen katër hidraulikë, të organizuar në dy grupe pune me nga dy persona.

9. Hidroizolues - 2 persona

Hidroizoluesit janë të nevojshëm për realizimin e hidroizolimit të rezervuarëve dhe elementeve që janë në kontakt të vazhdueshëm me ujën.

Preventivi përmban hidroizolim me dy shtresa me bazë çimentoje, waterstop në bashkimet e betonimit dhe materiale të tjera hidroizoluese.

Dy persona përbëjnë një skuadër minimale për përgatitjen e sipërfaqes, përzierjen dhe aplikimin e materialit dhe kontrollin e vazhdimësisë së shtresës.

10. Elektracist -2 persona

Elektricitetët do të realizojnë montimin e kabllave, paneleve, tokëzimit, ndriçimit, pajisjeve elektrike dhe lidhjeve të tjera të parashikuara në projekt.

11. Punonjës të konstruksioneve metalike - 2 persona

Këta punonjës kërkohen për përgatitjen dhe montimin e portave metalike, kapakëve, mbajtëseve, elementeve të fiksimit, shkallëve dhe konstruksioneve të thjeshta metalike.

Preventivi përmban porta metalike dekorative, konstruksione metalike të thjeshta, tuba çeliku dhe elemente metalike ndihmëse.

Ata do të bashkëpunojnë me saldatorët për montimin, pozicionimin dhe fiksimin përfundimtar të elementeve.

12. Shoferë - 6 persona

Shoferët kërkohen për drejtimin e automjeteve që do të përdoren për:

- transportimin e dherave;
- transportimin e agregateve dhe materialeve;
- furnizimin me tuba dhe rakorderi;
- përdorimin e kamionit me vinç;
- furnizimin me ujë të kantierit;
- transportin e pajisjeve dhe personelit.

Numri gjashtë lidhet drejtpërdrejt me automjete që kërkojnë përdorim të njëkohshëm sipas grafikut të mjeteve. Në dokumentet e tenderit janë parashikuar, ndër të tjera, kamionë, kamion me vinç, autobot uji dhe mjete të tjera transporti.

13. Punëtorë të thjeshtë - 20 persona

Punëtorët e thjeshtë janë të nevojshëm për realizimin e proceseve ndihmëse dhe manuale, si:

- gërmimet dhe pastrimet me krah;
- sistemimi i shtratit të tubacionit;
- transportimi dhe pozicionimi i materialeve;
- asistenca gjatë shtrimit të tubave;
- mbushja dhe ngjeshja e kanaleve;
- pastrimi dhe sistemimi i kantierit;
- sinjalizimi dhe sigurimi i zonës së punës;
- asistenca për betonimet, muraturat dhe rifiniturat.

Numri njëzet argumentohet nga shtrirja e objektit në disa nënobjekte dhe nga zhvillimi paralel i punimeve për një afat 6-mujor.

14. Manovratorë - 5 persona

Manovratorët kërkohen për përdorimin e makinerive të rënda dhe mjeteve teknologjike, si ekskavatorët me goma, miniekskavatorët, fadroma, trencher-i, grejderi dhe pajisjet e tjera të gërmimit e ngjeshjes.

Dokumentet e tenderit parashikojnë dy ekskavatorë, dy miniekavatorë, fadromë, trencher, grejder dhe mjete të tjera teknologjike.

Pesë manovratorë janë kërkuar për përdorimin e njëkohshëm të makinerive kryesore në frontet e ndryshme. Rregullorja aktuale e kantierit kërkon që makineritë dhe mekanizmat të përdoren vetëm nga punonjës të aftë dhe të autorizuar dhe ngarkon drejtuesin teknik të mos lejojë përdorimin e tyre nga manovratorë të pakualifikuar.

Dokumentet e punësimit dhe kualifikimit verifikohen vetëm për ofertuesin e renditur të parin, në përputhje me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për shoferët/manovratorët që lidhen me mjete të marra me qira lejohet kontraktimi për periudhën e zbatimit, kur disponueshmëria e tyre provohet së bashku me mjetin. I njëjti person nuk mund të deklarohet për role të papajtueshme ose në disa fronte njëkohësisht, ndërsa një kualifikim shtesë mund të mbulohet nga i njëjti person vetëm kur funksionet janë të pajtueshme dhe kjo lejohet nga legjislacioni.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar, të paktën personelin e mëposhtëm:

2.3.6/a Një (1) punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores ‘Për sigurinë në kantier’”.

Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqiten kontrata e punës, diploma dhe certifikata përkatëse; punonjësi duhet të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik për të paktën tre muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave.

2.3.6/b Për sigurimin e shërbimit mjekësor në punë, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose ta sigurojë këtë shërbim me kontratë të jashtme, në përputhje me VKM-në nr. 108, datë 09.02.2011, të ndryshuar me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015. Kur mjeku është i punësuar, paraqiten kontrata e punës, diploma, licenca për ushtrimin e profesionit dhe listëpagesat për të paktën tre muajt e fundit.

Kur shërbimi mjekësor sigurohet nga jashtë, paraqiten kontrata e vlefshme për këtë shërbim, licenca profesionale e mjekut ose e subjektit ofrues dhe dokumenti tatimor përkatës, sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.6/c Operatori ekonomik duhet të disponojë një (1) ekspert në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar sipas ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, neni 49, pika 4. Eksperti mund të jetë i punësuar ose i kontraktuar për zbatimin e kontratës. Sipas rastit, paraqiten kontrata e punës dhe listëpagesat ose kontrata e shërbimit, së bashku me diplomën/certifikatën dhe dokumentet që provojnë kualifikimin e tij.

2.3.6/d Operatori ekonomik duhet të disponojë një (1) inxhinier mjedisi ose specialist me kualifikim të barasvlershëm, të certifikuar si “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me përvojë pune jo më pak se tre vjet. Personi duhet të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik për të paktën tre muajt e fundit.

2.3.6/e Operatori ekonomik duhet të disponojë tre (3) persona të certifikuar për punime saldimit sipas standardit SSH EN ISO 9606-1:2017 ose ekuivalent, me certifikata të vlefshme të lëshuara nga subjekte të licencuara/akredituara ose organizma ndërkombëtarë të njohur në Republikën e Shqipërisë.

2.3.6/f Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë me një laborator të akredituar, ku të përcaktohet objekti i procedurës dhe testimet gjatë zbatimit dhe përfundimit. Laboratori duhet të jetë i akredituar të paktën për provën e rezistencës në shtypje të betonit sipas SSH EN 12390-3:2019/ASTM C39-C39M ose ekuivalent dhe për provat përkatëse të agregateve sipas SSH EN 1744-1:2009+A1:2012 ose ekuivalent.

Argumentimi: Kërkesat e pikës 2.3.6 lidhen me rreziqet reale të kantierit: kanale të hapura, gërmime në shkëmb, mjete të rënda, ngritje ngarkesash, betonime, energji elektrike, saldime dhe punë në rezervuarë/puseta. Përgjegjësi i sigurisë, shërbimi mjekësor dhe eksperti i mbrojtjes nga zjarri sigurojnë parandalimin dhe reagimin ndaj aksidenteve. Përgjegjësi për dëmet në mjedis nevojitet për kontrollin e dherave, mbetjeve inerte, pluhurave, zhurmës dhe rikthimin e sipërfaqeve. Tre saldatorët e certifikuar kërkojnë për montimet metalike dhe punën paralele në disa fronte. Laboratori i akredituar është i domosdoshëm për kontrollin e betonit dhe agregateve të rezervuarëve, pusetave dhe strukturave betonarme. Këto kërkesa bazohen në nenin 77 të LPP-së, nenin 39, pika 6, të VKM-së nr. 285/2021, si dhe legjislacionin e sigurisë, shëndetit, zjarrit dhe mjedisit.

2.3.7 Makineri dhe pajisje

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

N r.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	në pronësi ose me qira	copë	4
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	copë	2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 5 deri në 10 ton	në pronësi ose me qira	copë	1
4	Makineri prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	copë	1
5	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	2
6	Minieskavator	në pronësi ose me qira	copë	2
7	Fadromë me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
8	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	copë	1
9	Trencher për hapje kanali	në pronësi ose me qira	copë	1
10	Grejder (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
11	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	copë	1

12	Autobot uji	në pronësi ose me qira	copë	1
13	Autobetonjerë	në pronësi ose me qira	copë	2
14	Rul vibrues Gomë-Hekur me kapacitet mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	copë	1
15	Rul vibrues Gomë-Gomë me kapacitet mbi 12 ton	në pronësi ose me qira	copë	1
16	Rul asfalti i vogël deri 4 ton	në pronësi ose me qira	copë	1
17	Autopompë Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2
18	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2
19	Betoniere të vogla	në pronësi ose me qira	copë	2
20	GPS	në pronësi ose me qira	copë	1
21	Kontejner stacionar (zyrë, dhomë ndërrimi)	në pronësi ose me qira	copë	1
22	Betoforma/kallëpe	në pronësi ose me qira	m ²	200
23	Skela + rjete mbrojtëse fasade	në pronësi ose me qira	m ²	300
24	Kokore	në dispozicion të punonjësve	copë	50
25	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	në pronësi ose me qira	copë	1
26	Jelekë fosforeshentë	në dispozicion të punonjësve	copë	50
27	Matrapik	në pronësi ose me qira	copë	5
28	Aparat për kthim hekuri, Tranxhë hekuri	në pronësi ose me qira	copë	2
29	Gjenerator	në pronësi ose me qira	copë	1
30	Depozita uji minimumi 5000 litra	në pronësi ose me qira	copë	2
31	Aparaturë për test presioni tubash	në pronësi ose me qira	copë	1
32	Deflektometër ose pllakë dinamike për matjen e ngjeshjes së shtresave rrugore	në pronësi ose me qira	copë	1
33	Çekiç pneumatik për thyerjen e betoneve	në pronësi ose me qira	copë	1
34	Termometër për matjen e temperaturës së përzierjes	në pronësi ose me qira	copë	1

35	Pompë uji për pastrim	në pronësi ose me qira	copë	1
36	Aparaturë me ultratinguj për matjen e trashësisë së betonit	në pronësi ose me qira	copë	1
37	Aparaturë me ultratinguj për kontrollin e uniformitetit të betonit	në pronësi ose me qira	copë	1

Për të provuar disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve, dokumentacioni provues paraqitet sipas natyrës dhe mënyrës së disponimit të tyre, si më poshtë:

- Për mjetet që regjistrohen në regjistra publikë dhe janë në pronësi, paraqiten dokumentet që provojnë pronësinë dhe gjendjen e tyre ligjore: certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni, leja e transportit kur kërkohet, si dhe fotografi të qarta ku të dallohet targa e mjetit.
- Për mjetet e marra me qira ose nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit, krahas dokumentacionit të zbatueshëm për mjetin, paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.
- Për pajisjet që nuk regjistrohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi paraqiten dokumentet e blerjes, zhdoganimit ose faturat tatimore dhe fotografite përkatëse; kur disponohen me qira ose bashkëpunim, paraqitet edhe kontrata përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet paraprakisht me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për mjetet dhe pajisjet paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Lista e makinerive dhe pajisjeve mbështetet në nenin 39, pika 6/d, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, dhe në analizat teknike të çmimeve. Kamionët, ekskavatorët, miniekskavatorët, fadroma, trencher-i dhe mjetet e transportit nevojiten për gërmimet, transportin e dherave dhe shtrirjen e tubacioneve në disa fronte. Prerësja e asfaltit, grejderi dhe rulët lidhen me rikthimin e shtresave rrugore. Autobetonieret, autopompat, vibratorët, betoformat dhe skelat lidhen me rezervuarët, pusetat dhe muret betonarme. Pajisja elektro-fusion dhe aparatura e provës së presionit lidhen drejtpërdrejt me tubacionet PE100 RC dhe testimin e rrjetit. GPS-ja dhe pajisjet e kontrollit lidhen me piketimin, ngjeshjen dhe verifikimin e cilësisë.

Sasitë janë përcaktuar duke marrë parasysh grafikun 6-mujor dhe zhvillimin paralel të punimeve. Lejohet pronësia, qiraja ose një formë tjetër e ligjshme disponimi për të gjithë periudhën e kontratës. Dokumentacioni i pronësisë, qirasë, regjistrimit, kontrollit teknik dhe fotografite kërkohen për të verifikuar disponueshmërinë dhe gjendjen ligjore të mjeteve; nuk kërkohet dokument i papërshtatshëm për pajisjet që nuk regjistrohen në regjistra publikë. Pajisjet personale të mbrojtjes duhet të jenë realisht në dispozicion të punonjësve dhe të plotësojnë kërkesat e sigurisë.

2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me:

- Licencë/akt miratimi për veprimtarinë e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta inerte, nënkategoria III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Argumentimi: Gërmimet, prishjet e shtresave të betonit/asfaltit dhe transporti i materialeve prodhojnë dhera dhe mbetje inerte. Licenca III.2.B kërkohet që largimi dhe transporti i tyre të kryhet nga subjekt

i autorizuar, me gjurmueshmëri dhe në destinacione të ligjshme, në përputhje me ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ligjin nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore për licencimin. Kriteri lidhet drejtpërdrejt me zërat e gërmimit, prishjes dhe transportit në preventiv.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij.

Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve të mëposhtme ISO ose standardeve ekuivalente, të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- e) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent. (Aktivitete saldimi per punime te ngjashme ndertimi). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- f) Certifikatën Konformiteti CE të komponentëve struktural per strukturat metalike **EN 1090-1:2009+A1:2011**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një

organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatat ISO që lidhen me natyrën e punimeve dhe pjesën e kontratës që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Impianti i prodhimit të inerteve dhe impianti i betonit kërkohen për të garantuar furnizim të vazhdueshëm dhe të kontrolluar me agregate, beton, shtresa çakëlli/stabilizanti dhe elemente betonarme, brenda grafikut 6-mujor. Kriteri nuk kërkon domosdoshmërisht pronësi; pranohet qiraja ose kontrata e bashkëpunimit e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit.

Certifikatat ISO, ose ekuivalente, janë të lidhura drejtpërdrejt me menaxhimin e cilësisë, ndikimeve mjedisore dhe rreziqeve të sigurisë në një kantier me gërmime, punime rrugore, struktura betonarme dhe instalime hidraulike. Ato kërkohen në përputhje me nenin 44 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organe të akredituara. Në rast bashkimi operatorësh, certifikatat paraqiten sipas natyrës së punimeve që merr përsipër secili anëtar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- **Çertifikatë ISO 9001 - 2015** “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe

mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.

- **Çertifikatë ISO 14001 - 2015** “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kerkohet pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit eshte nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi, kurse metoda me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombetar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 bëhet pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhen kryer në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi*, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Çertifikatë ISO 45001-2018** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” mundeson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.

Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Çertifikatë ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *në lidhje me vlerësimin e rreziqut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor*, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

- **Çertifikatë ISO 50001-2018** është standardi ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë (EnMS – Energy Management System). Ai u ofron kompanive një kornizë të strukturuar për të përmirësuar performancën energjetike, për të rritur efikasitetin e energjisë, për të ulur konsumin e energjisë dhe për të përdorur energjinë në mënyrë më të qëndrueshme. Standardi mund të zbatohet nga çdo kompani ndërtimi, pavarësisht madhësisë, sektorit apo vendndodhjes. Qëllimi i ISO 50001:2018 është që organizata të: Përmirësojë vazhdimisht performancën energjetike, Ulë kostot e energjisë,

Zvogëlojë ndikimin në mjedis dhe emetimet e gazeve serrë, Sigurojë përputhshmëri me kërkesat ligjore që lidhen me energjinë.

- **Certifikatë ISO 3834-2:2021** Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike – Pjesa 2: Kërkesa të plota të cilësisë është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për organizimin, kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së proceseve të saldimit. Standardi zbatohet si në punishtet e prodhimit ashtu edhe në kantieret e ndertimit apo montimit dhe përdoret nga organizatat që kryejnë saldim si pjesë e proceseve të tyre të prodhimit. Qëllimi i standardit, ISO 3834-2:2021 është të sigurojë që proceset e saldimit planifikohen, kryhen, monitorohen dhe dokumentohen në mënyrë të kontrolluar, në mënyrë që produktet e salduara të përmbushin kërkesat e cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë.

Certifikata e Konformitetit CE sipas EN 1090-1:2009+A1:2011 vërteton se komponentët strukturorë prej çeliku ose alumini janë prodhuar në përputhje me kërkesat e këtij standardi evropian dhe mund të vendosen ligjërisht në tregun e Bashkimit Evropian me markimin CE. Standardi EN 1090-1:2009+A1:2011 përcakton kërkesat për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) të komponentëve strukturorë metalikë. Ai zbatohet për elemente si trarë, kolona, korniza, lidhje të salduara, komponentë industrialë dhe pjesë të tjera mbajtëse të konstruksioneve prej çeliku ose alumini.

2.3.11 Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:

- a) Tubo Ujësjiellësi
- b) Hekur
- c) Rakorderi Ujësjiellësi
- d) Materiale elektrike,

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë certifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.
- Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane të pajisura me certifikatë ose deklaratë konformiteti CE.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

2.3.12 Për matësit e ujit

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ose deklaratë të prodhuesit/distributorit të autorizuar që vërteton se matësit e ujit prodhohen dhe testohen sipas OIML R49 ose një standardi ekuivalent, në përputhje me rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë aprovimi MID sipas Direktivës 2014/32/BE për instrumentet matëse, ose dokument ekuivalent të njohur, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për metrologjinë.

Argumentimi: Tubacionet PE100 RC, rakorderitë, valvulat, matësit, çeliku dhe materialet elektrike janë elemente që mbeten në vepër dhe ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë higjienike, rezistencën ndaj presionit, saktësinë e matjes dhe jetëgjatësinë e rrjetit. Dokumentet e burimit të furnizimit, katalogët dhe deklaratat/certifikatat e konformitetit mundësojnë verifikimin e parametrave të ofertuar pa kufizuar konkurrencën vetëm te një prodhues ose distributor. Për matësit e ujit, OIML R49 dhe aprovimi MID ose ekuivalent garantojnë saktësinë metrologjike dhe përshtatshmërinë për faturim. Këto kërkesa bazohen në nenet 36 dhe 77 të LPP-së dhe nenin 44 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar.

Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipercituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 285 datë 19.05.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në**

specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2.3.13 Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 6 (gjashtë) muaj, sipas Grafikut të Punimeve të publikuar në SPE.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr.8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:*

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Argumentimi: Afati 6-mujor është mbështetur në grafikun e hartuar nga projektuesi dhe në rendin teknologjik të punimeve. Pika e lidhjes dhe linjat e dërgimit nisin në fazat e para; rezervuari dhe rrjeti Gërhot zhvillohen në vijim; rezervuari dhe rrjeti Virua, lidhjet me objektet dhe muret e matësve zhvillohen me mbivendosje; testimet dhe vënia në funksion kryhen në përfundim. Afati është i realizueshëm vetëm me mobilizim të hershëm, fronte paralele dhe koordinim të furnizimeve, prandaj ofertuesi duhet të paraqesë grafik në përputhje me afatin maksimal, pa cenuar rendin teknologjik dhe cilësinë.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës kërkohen nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar. Paraqitja bëhet në formën

e kërkuar nga legjislacioni dhe SPE; mosparaqitja ose mospërputhja me vetëdeklarimin trajtohet sipas dispozitave në fuqi.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar mbi projektin, preventivin dhe analizat teknike të çmimeve dhe përcaktojnë materialet, proceset e zbatimit, testimet dhe kërkesat e cilësisë për tubacionet, rezervuarët, pusetat, valvulat, matësit, punimet betonarme, gërmimet dhe rikthimin e shtresave. Ato janë formuluar në mënyrë funksionale dhe të matshme, pa referenca diskriminuese ndaj markave ose origjinave të caktuara, dhe çdo standard shoqërohet me shprehjen “ose ekuivalent”, në përputhje me nenin 36 të LPP-së dhe nenin 39, pika 2, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar.

Njësia e Prokurimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin teknik dhe argumentimet e mësipërme, miraton specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim në formën e këtij procesverballi.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____
2. _____
3. _____